Këtë betim e realizoi me obligimin më të madh, dhuroi jetën për lirinë e Kosovës

Vdekja është e bukur,kur i dhurohet lirisë

Halit Coka - Hero i Kosovës

Parathënje

Nuk shkrova me penë por me zemër. Se zemra ime përmban thesarin e ndjenjave të tij. Dhe kur shkruan për një njëri të afërt e shumë të dashur më duket sikur kam dy zemra. Dhe kujtimet që kisha për Halit Cokën, nuk desha t'i mbajë në memorje, t'i kem pronë personale që jetojnë vetëm me mua. Unë kam mallë për Halitin. Mall prej zemre! Dhe malli nuk shuhet me një pikë ujë. Këtë mall ma shuan Z.Sheradin Berisha me botimin e këtyre kujtimeve në portalin "Pashtriku", që është vëndi ku luftoi dhe ra hero në zonën e Dukagjinit.

Jetë e shkurtër plot heroizem

--E prap punon,por i lodhur në shpirtë e në zëmër!...

Dhe prap dëgjon.....Karvanët,përdhunimi dhe masakrimi i Kosovës,arriti kulmin,dhe kulmin ë durimit arriti në shpirtin e zemrën e Halitit...

Punën e ndërpreu,i ktheu shpinën plot urretje,shfrytëzimit nga puna e huaj dhe me zë të fuqishëm tha:

‘”Lamtumirë Greqi!

Ju përshëndes UÇK!

Më prit Kosovë!

Aty më kë”!!....

Vendim ky i heshtur,në zemër të thyer,për atë që dëgjoj,por dhe sekret i ruajtur në fshehtësinë e mendimit të tij,për të mos mbjellur hidhërim dhe pengesë në rrugën ë zbatimit të këtij vëndimi solëm.

“Heroi i Kosovës” Halit Coka (Vullnetar nga Kukësi)

Kombi dhimbjen e këthej në forcë

Nga mërgimi në luftën e Kosovës

Fluturoj lartë në qiellin e kaltër,
Një yll shkëputet nga zemrat tona
U ul mu në mes të Kosovës

Për të rrëzatuar dritë lirie.!.....

Në ato vite kur Shqipëria u hap,vala e mërgimit mori me vehte dhe dëshmorin e ardhshëm të Kosovës,Halit Coka,i cili përfundoj në Greqinë ë lashtë për të punuar e ndihmuar familjen e tij. Ai u ndesh me shumë vështirësi në punë të ndryshme, nga më të vështira.Dashuria për punën,dhë urrejtja për shfrytëzimin e bënte dhe më të palodhur dhe më rezistent.

Pa pritur dëgjon në radio,- Kosova rrezikohet për luftë e genocid.

Ai punon dhe prap dëgjon!...

-Në Kosovë bëhet luftë,uçk po lufton!.....

--Punon dhe prap dëgjon...Kosova digjet në flakë,vriten fëmijë ,burra e gra!...

këmbë e vështirësi.Mendja shkon atje ku pak orë më parë kishte gëzuar e qeshur me njerëzit më të dashur që për këtë moment i duket sikur po i tradhëton se luftës nuk i dihet!?.....

Mënjëhërë një ofshamë del nga shpirti i tij:

--O ju male lamtumirë!!?..

-O Vllezër, motra, prindër e shokë; njerëzit e mi të dashur!? U takofshim në Kosovën e lirë!?

I shoqëruar futet mbrënda me ngadal me atë urtësinë që ai kishte. Befas ndeshet me shikimin zhbirues të komandantit,i cili kërkonte të lexonte diçka në fëtyrën e tij plot shpresë e optimizëm?

Dy shikime, dy duar të shtërnguar fort njëri me tjetrin!...

Të na rrojë Kosova,-Thotë Haliti më zë të fortë e burrëror,plot forcë e entuziazëm!!....

Në ato ditë të ftohta janari shkon në shtëpi,përsheëndetet me mall e përqafimë me të gjithë..Të gëzuar e të qeshur për prezencën e tij në familje dhe këthim shëndosh nga kurbeti.

Po kalojnë orë ,minuta e ditë ,në zemrën e tij,hapeshin plagë kur dëgjonte marrëzirat e shekullit ndaj popullit trim e liridashës të Kosovës trime dhe heroike.I zhytur në mendime ,plot ëndrra e fantazi,u gjend pran prindërve e vllazërisë.Gëzim e plot hare,të gëzuar për mireseardhjen e Halitit në mesin tonë.

Ai me një luftë të mbrendshme, atë natë duhej të përballonte dy të kundërta në mendje e në zëmër!?...

Të qeshte e të gëzonte me njerëzit që e donin aq shume dhe pa rënë në sy bluante mendimin për të shkuar atje ku zbatimi i vëndimit dukej i

vonuar në kohë.Drita doli,një shkëndijë u shkëput nga zemrat tona,fluturoj larg ...larg....!

Atje në Kosovë,ku do të rrezatonte,dritë...dritë..dhe vetëm dritë e shpresë për ato që vuajnë e përdhunohen ,diskretitohen në formën më mizore të paparë në histori.

Dëborë ,shi.....furtunë,...diku më këmbë e diku me makinë,i lodhur e i drobitur,me shpirtë të trazuar,u gjend pran repartit x .

Aty bëhëj regjistrimi dhe hidhej firma për të luftuar për liri të Kosovës ose për të dhënë gjënë më sublimë për këtë popull që përjeton mizorinë më të egër.

Pak minuta e ndajnë Halitin,për realizimin e vendimit të tij sa sublim aq dhe patriotike.Ky

vendim flinte i qetë në zemrën dhe në botën shpirtërore të trazuar.

Hekurat e repartit për këtë moment ndajnë dy botë,plot fantazi,kurajo shpresë ,vetëmohim të gatuar me trimëri!.....Para syve sheh shokët ,të cilët prisnin dhe stërviteshin për tu futur në orët e vona në frontin e luftës,në anën tjetër,

priste me mirënjohje momentin kur ai të firmoste për tu futur në luftë dhe, kënaqësia më e madhe ishte se realizojë vendimin që flinte në zemrën tij .

Momenti erdhi.....Ai thirrej për të marrë miratimin nga komandanti....

Para se të futej në komandë,kthen sytë e shikon ,me vështrim të thellë e zhbirues, ato male të lartë, ato kodra e lugina ku kishte kaluar me

Do të bëhem fli për idealet e këtij populli ,që të hidhet poshtë ajo bajonetë që në barkun e nënës merr dy jëtë.

Duar të shtërnguar fortë....U tundën dy duar!.Para syve u ndërthurën dy jetë, dy botë e më së fundi. Ai,ndodhet në rrjesht,sheh veten me rroba ushtari,me çantë plot fishekë,dhë pushkën në krah ....gati për luftë....U realizua ëndrra që e mundonte prej kohe. Orët kaluan,nata erdhi...Të gjithë në këmbë,gati për marshim në orët e ërrta të natës sapo dielli u fut në horizont.

Një çetë e vogël,por me zemër të madhe mori udhën midis tyre dhe dëshmori i ardhshëm i Kosovës Halit coka. Dëborë,shi e furtunë përkdhelnin trupat plot ngarkesë ,duke udhëtuar atyre maleve, kodrave, pyjeve e

-Nga je ti more djalë që për Kosovë ke kaq malle?--Thot komandanti me zë të qetë e plot mendime.?!!..

Jam nga Arni ,në malësi që në taban kan besë ë burrëri, përgjigjet Haliti shumë i qetë e plot krenari!.

Kam marr vendim të shkoj në luftë ë të ndihmojë ata njerëz që të mos vuajnë më ,të mos derdhin gjak,të mos derdhin lot se dhe ata kanë shpirtë e zemër si unë dhë ti,komandant! Komandanti i habitur nga vendosmëria e këtij djali,në mënyrë të qëtë e i habitur kap stilolapsin dhe shkruan emrin,mbiemrin,datëlindjen e fshatin. Ulë stilolapsin dhe mendon thellë!?...Ngren kokën ngadal,shikon atë fëtyrë,fëtyra plot dritë,që rrëzatonte duke pritur urdhërin për miratim e nisjes drejtë!...

Ai kënaqej,zemra i rrihte fortë,u realizua premtimi i fshehur që tani po del në fushën e mejdanit për tu bë ushtarë i UÇK! !....

Kap më forcë stilolapsin,e shtërngon fortë, e me buzë në gaz nënshkroj vendimin:-"jam ushtarë i uçk,lufta ime do të jëtë e vendosur dëri në obligimin më të madh,për të shembur botën mizore që merr nëpër këmbë mijra njerëz të pafajshëm"!?.....

--Moment kritik në botën e tij shpirtërore.Dora mbeti pezull,kur stilolapsi do hedh firmën.Në majën e këtij lapsi pushojnë dy botë:--Bota ë ngrohtësisë familjare që po perendonte nga pas dhe bota e luftës që po afrohej përfundimi i të cilës nuk dihet!?....E firmos mbi letër,firmos për luftë,firmos për një jetë më të mirë e të lirë të Kosovës...

Ngrihet në këmbë Haliti ,mban drëjtëqëndrim,si një ushtarë i lindur në luftë ,i edukuar në luftë,i formuar në luftë,dhe me krenari i drejtohet komandantit:

- "Ju falemnderit komandant!...Më shëruat plagën më të madhe që nuk arrita ta mjekoj deri tani.Kjo plagë u krijua që kur Kosova u djeg në flakë ,u mbulua me gjak ,u mbyt me lot nga sytë e pa fajshëm.E kam mbajtur të fshehtë e më ka munduar shumë deri tani që mora liçencën e luftës....për tu bë ushtarë i uçk,hodha firmën për të matur luftën time me fitoren e popullit kosovar".

Hodha firmën për ty Kosovë e ndoshta!? ...fli do bëhem!

tyre u vriten nëna ,baba,vëlla e motër!?.....Habi ,heshtje...!

Është thirrja e njerëzve që varrosen të gjallë në varreza masive!?.....

Mendova:--Si mund të çlirohem nga kjo zemër e thyer plot brenga!?.

Nga thellësia e zemrës buron urimi:

-Ju lumtë pushka o vllezër të uçk!....

Së shpejti do të zhduket hija e zezë e kësajë kuçedre të tërbuar!?...Kështu mendonte në kohët më të errta që kalonte Kosova,Halit Coka .

Këtë brengë të mallkuar e hoqi,vetëm kur lëshojë mbi krah pushkën e gjatë dhe luftën filloj me egërsinë e urrejtjes,për bishën që terrorizonte njerëzit e pafajshëm !?....Kosovën martire.

greminave, plot errësirë e në një vend të pashkëlur. Me duar shtërngonin armën duke qënë vigjilënt ndaj çdo të papritur. Lodhja e madhe mes stuhive e dëborë,errësirë e plote i shoqëronte kudo.Gjatë këtyre vendeve,tepër të thepisura,dhe në rrezikshmëri të plotë.

Vrullin dhe vendosmërinë e Halitit gjatë maleve e rrugëve të vështira e ndriçonte, duke bërë natën dritë,flaka e pushkës që do të shpalosej ndaj çdo të papritur sa do e vështirë që të jëtë...do shpalosej ndaj egërsisë që bën një mizori të paparë në historinë ë popujve...

Pra ëndrra u realizua,brenga u shërua,lufta filloi.

Në ditët plot luftë ,në radhët e uçk u shtua dhe një pushkë...

U shtua dhe një ideal,plot patriotizëm,plot kurajo vendosmëri, për tu bërë barrikadë e pakapërcyeshme!

Në këto kushte sa të vështira,plot lodhje,në shi e furtunë,marshonin të qëtë e plot vigjilencë çeta e vogël,por me zemër të madhe...

Tre rreziqe ndodhin përballë tyre,moti i ftohtë,fushat e minuara dhe prita që i prisnin forcat para militare.Vendosmëria,durimi dhe vigjilenca bëri që ato së shpejti të ishin pran destinacionit ku i priste me krahhapur e terë Kosova!....

Furishëm unë them këto mendime që burojnë nga zemrat e trimave:

“Çeta e vogël me pak vetë

Shkon në luftë shumë e qetë,

Këto petrita,djem të ri

Halit coka u ka pri!

Me krah hapur ,të prêt Kosova

Djal i Arnit Halit Coka!

T’ prêt Kosova e gjakosur

Trup e shpirtë e sakatosur”.

Brëngë në shpirt e zemër

Një brengë e fortë më shtërngon në zemër.!

Është brënga e vuajtjes e mjerimit që përjeton Kosova një gjymtyrë e shkëputur nga trupi ynë, Shqipëria...

Brenga që më mundon është terri si nata!...Është dita plot mjergull që s’lejon rrezet e diellit të ngrohin këtë tokë të vuajtur Kosovare!.....

Ajo që më mundon,është flaka e shtëpive që digjen!.Është drithërima e fëmijve që, në sytë e

këmbëzën e pushkës që këndon vendçe mbi padrejtësitë!.....

Urrejtja ndaj atyre që dogjën shtëpi,vranë njerëz fëmijë ,burra ,gra të bën më të fortë së asnjë herë!?.....

Urrejtja të bën dritë për të parë në fushën e luftës,thoshte Haliti!?....Dashuria për liri gërshetohet me urrejtjen dhe nxjerrin në finale fitoren!?....E kështu kur milicët tureshin me sy të zgurdulluar,urrejta përcolli ngadalë në zëmrën e tij plumbin plot zjarr!?....Këto mendime në formë dialogu buronin si rezultat i debatit mes mendimeve të mija dhe ato të Halit Cokës,të realizuar në kushte pushimi me shokët dhe bashkëluftëtarët e luftës në Kosovë !?.....

Dialog me shokë lufte

Ushtari i UÇK

Ishte një shkëndijë që u shkëput nga zjarri në vatër e kaloj nëpër oxhakun tonë !.. E sulet për liri...Në luftë me vetëmohim...

Haliti,ushtarë i uçk,ishte njeriu më fatzi që luftoi për tu bërë njeriu më fatbardhë.

Haliti,ushtar dhe epror i uçk, ishte njeriu që hodhi prangat ,hodhi pushkën mbi krah dhe u fut në luftë për tu bërë Ylli i lirisë,!?.....

Fluturoj si shqiponjë ndër male, u ul në zemër të Kosovës dhe lëshoj fuqishëm zërin:

--‘’Së bashku me ju do të hedhim në greminë fantazmën që prodhoj këtë tragjedi sa të egër aq dhe të rëndë.

Rroftë Kosova!Lartë liria!!....

Je i gjallë në zemrën time

Mbushem me krenari ,kur të shoh të veshur e të ngjeshur me atë armë i dashur hero!?....

Të shikoj ballin tënd, –Balli yt plot dritë.

Të shikojë sytë , --Sytë e tu plot zjarr.

Të dëgjoj fjalën, -Fjala jote plumb dhe dora jote shpatë!?.....

Më gufon zemra të pija ujë në ato burimë ku ke pirë ti në ato ditë të vështira të luftës,-o hero ynë!?....Më dëshiron zemra të shkelja ato vende ku ju zinit pritë dhe pushka jote t'ia thoshte këngës!?...Përpara rrebeshit qëndrove si mal që nuk tundet as nga era dhe as nga furtunat galopante!?.....

Përball tankut u bëre shkëmb!...

E shkele tankun më këmbë dhe u shëndrrove në ylbër,për të lëshuar përherë mbi tokën Arbërore reflekset e heroizmit!.....

Trimëria e heroizmi të shëndrroj në ushtarë të përjetshëm!.....

Me pushkën shtërnguar mbi gjoksin tuaj barrikadë.!?.....

Zemra ime nesër nuk është,vepra juaj jeton në shekuj.

Dialog më vehten

I tretur në mendime të thella ku ngjarjet rrokulliseshin, në mendjen time si retë që i trazon era në një ditë plot stuhi.....i thash vehtes:--"Jo,...jo nuk duhet forca e traktorit për të shkrehur pushkën ndaj një armiku sa të rrezikshëm aq dhe të urryer që kërkon të përpijë të gjallët"!?....

Urrejtja për atë që tenton të rrëmbejë jetë njerëzish,të jep forcë ,të ngushllon dhe të bën mal për të shembur male,e jo më për të tërhequr

trim i paparë. Sa herë dilnin në luftë kishin dëshirë ta kishim në krah,si në sulm apo në pritë.. Ai çan nëpërmjet plumbave si rrebesh ,si një rrebesh!...Gjithëkush nga Kosovarët i vinin gishtin kokës mendonin thellë dhe diskutonin duke thënë:

----''Kur ushtari dhe eprori i ardhur vullnetarë nga Shqipëria,po vëtësakrifikohët në beteja e luftra të pa shëmbullt,për ta parë Kosovën të lirë,ne bijtë e Kosovës do ta nderojmë si vullnetar ,do ta mbështesim në beteja dhe do ta kemi burim frymëzimi në luftra të tjera!...

Haliti është njeriu më i mirë dhe trimi më i madh në luftën tonë.

Djali nga Shqipëria

Shumë gra e fëmijë rrinin në qiellin e hapur në rrugë,në fushë,në kodër apo në pyje plot lagështi.

Halit ,-"Kur e ke pa vehten më ngushtë"?

-E pyeti një nga shokët në një natë plot errësirë e të ftohtë në një shtëpi përdhese që pritej të kalonin natën për tu hedhur në luftë ditën që do të vinte.

Ai ngadalë,duke mbajtur në njërën dorë një urë zjarri dhe duke përpushur hirin tha:--Në momentin kur midis dashurisë prindërore dhë dashurisë për atdhe,triumfoj ajo e dyta!...

Këtë vlerësim e bëjnë të rrallë dhe të rrallë jemi ne këtu që luftojmë me motin dhe me armikun të tërbuar!?...

-Më ngushtë e kam pa vehten kur, shoku në krah mbeti i vrarë dhe plumbat e breshëria e predhave më pengonte ta ndihmoja ,për ta nxjerr nga transheja dhe,mbi të gjtha duhej të mbroja trupin e tij dhe të shokëve të tjerë që hapnin

zjarrë pa pushim në gjoksin tim dhe me pushkën e gjatë !.....

-Kur një copë predhë shkatërroj qytën e pushkës shtërnguar fortë mbi gjoks!...-

-Mu duk vehtja si një njëri pa këmbë ,pa duar dhe i tepërt në këtë llogore ku shuheshin jëtë dhe vetëm jetë!?.....----Kulmi i trimërisë ishte atëherë kur tanket e tërbuar villnin vrerë e turreshin për të na shtypur pa mëshirë,një predhë e hudhur nga dora ime shkatërroj tre tanke,dogji tre ekipe njëherësh dhe mbrojti dhjetra jetë në transhe !..

Epror shembullor

Ndjehesha i lumtur kur dëgjoja nga goja e bashkëluftëtarëve dhe shokëve të një llogorje me heroin e Kosovës Halit Coka!?....Gjithëkush ishte

i lumtur kur shikonte atë djalosh që rrinte pak si i heshtur dhe në mendime të thella...

--Ai është nga Shqipëria,bisedonin kosovarët njëri me tjetrin. E kalon jetën në llogore bashkë me ne ...

...Ërdhi vullnetarë nga Shqipëria,trim ,i urtë e i vendosur...Ai e nuhaste nga larg rrezikun që vinte nga frontet e luftës,-- thonin ato....

Përdorë çdo lloj arme e çdo lloj mine apo granate ,mjeshtër në teknikë ,mjeshtër e trim në vëprim,-thonin njëri tjetrit me zë të ultë ë plot optimizëm...

Nuk janë të lehta ato punë, ishin shumë të rënda sepse jeta dhe vdekja qëndronin shumë afër njëri tjetrit dhe rrethonin gjithëkund djalin e ri vullnetar nga Shqipëria..Të gjithë bisedonin njëri më tjetrin :---Ai ,Haliti,është njeri i rrallë,

---"Ushtarët e uçk janë Mic Sokolat e ditëvë tona,janë ata që shembën masakrën me heroizëm të paparë!...

Heroizmin e tyre do ta përjetojë në këngën me çifteli"—gjithë brezat që do vijnë në shekuj të mëvonshëm!...

Haliti kishte një zemër si gjithë të tjerët,por në luftë atij iu deshën disa zëmra:

-Një zemër për të dashur atdhenë,shqipërinë.

-Një zemër për të mbrojtur vehten....

-Një zemër për të mbrojtur shokët ...

-E një zemër që del nga gjoksi,para tankut!...

Ta dish se ç'është pushka

-Kush e di së ç'është plaga e plumbit!?

Kush e di ç'është fishkëllima rrëshqitse e flakës së grykës së murtajës!?....

Binte shi.... Ata aty në ato vende plot ujë e rrebesh.Binte borë,....Ata aty ,të zhytur në vuajtje e mjerim plot dhimbje!?...

Binte breshër..Ata aty,sikur dh**e** prej diamanti të ishin do të shkriheshin e jeta të fundosej!?...

--Milicët suleshin me automatik në gjoks..e tentonin t'i vrisnin e masakronin....-Suleshin me thika në dorë për të marrë jetë të pafajshme të fëmijve që nuk din çfarë po ndodh para vdekjes!?.....

-U sollën që të hapin shteg...

Po nga goja e Halitit dëgjohet thirrja:--"Ndal beg se ka hndek"!?...

Me pushkë në dorë pritën në shteg vrasësit dhe më furi shkatërrohen e bien në gremina....

E vrasës të tjërë goditën në lartësi me pushkë e topa.Përleshej në këto lartësi jeta me vdekjen.Në

këtë çast iu desh llogores edhe një zë i furishëm!... Një pushkë më shumë!?..

Është zëri dhe pushka e Halit Cokës,djalë nga luma e kuqe!...I cili nëpër tym e flakë erdhi dhe shkrehu një pushkë,lëshoj një zë:-"Ja erdha",erdha dhe po dëgjohej krisma, është krisma e pushkës sime, është zëri i Kuksianëve!

Është sinjali i lirisë !?

Mic Sokolat e ditëve tona

Atëherë kur në Kosovë bëhëj luftë vriteshin jo vëtëm burra që shkonin në luftë ,por dhe!.....

--Prdhat të shkurtonin e thyenin këmbë burrash,fëmijësh ,grash e pleqësh...!?

--Plumbat kishin shkurtuar dorë e nxjerr sy të pafajshëm!?

---Prindërve iu vranë fëmijtë e fëmijve u vranë prindërit..

--Vendi mbushur me vorreza masive. Masakër!...legjendë!....

Mendja më vajti te Mic Sokoli e kënga e tij :

"Mic Sokolin se vrau reja
Se vrau reja se vrau moti
E vrau Dervish Pasha
Me gjyle topi".

Këto masakra nuk u bën në kohën e Micit, e ai i vuri gjoksin topit!..

-Përballë kësaj masakre,të pa parë gjoksin tankut ia vurën ushtarët e uçk ,ia vuri dhe trimi Halit Coka!?.....

Prandaj me mendje të qartë e me plot bindje them:

Papritur më duket sikur ai erdhi dhe qëndroi para meje,u këthye në ëngjull dhe më tha:

-"Erdha të gëzojmë së bashku këtë festë të madhe"..

Erdha të fuqizojmë hapin tuaj në këtë parakalim festiv që e stolisëm me gjakun tonë!

-Erdha t'iu sjell gëzim në buzët tuaja!....

Erdha të shikoj në këtë gëzim të madh,dritën ë lirisë!..

-Të shikoj e të gëzojmë festën e pavarsisë!!..

_Erdha të festojmë ditën më të bukur e të madhe obligimin tim më të madh!.....— Rëbublika e Kosovës!...E Ai, duket sikur u larguan duke marr me vete buzëqeshjen!...

Pa nga afër pavdekshmërinë në zemrat tona

e më së fundi me krenari Ai, deshi të thotë:

Dihet që të dridhurat e flakës së pushkës ,flaka e murtajës , krisma e topit është përshëndetja e vdekjes që ndodhej shumë afër tyre!?...

Kush e di ç'është zhurma e tmerrshme dhe uturima e tankeve!?.....

Por as pushka ,as topi dhe as tanket nuk mund ta shuajnë kurrë fkakën e pushkës tuaj ,o trima të uçk,!.....

As kurrë ,o trim i rrallë Halit Coka që me mjeshtëri e guxim e përdorë atë armë .

Krisma e armës suaj është dritë për gjithë rininë Kosovare!.....

Për mbarë ata që e dinë se ç'është atdheu, ç'është pushtuesi, që të vjen në vatër dhe të nxjerr në rrugë për të mos u këthyer më në shtëpinë tënde!?...,,

Ja pra ç'është trimëria ! ?..

Ç'është lufta?Jane ata që jetën e dhënë në luftë e quajnë ditëlindje në kohë paqe!?.....

Ë pra! ..-lart trimëria juaj Halit coka!.....

Lart lavdia!...-Jote në shekuj!..

Heroizmi juaj plot krenari e plot lavdi!?...

Arni i vogël,trima të rrallë

"Djemtë e Arnit plot energji
E kan shkruar me grykë të pushkës
Në fushë t' mejdanit,në front të lufës"!...

Tre djem të ri ,tre sokola me armë në dorë u futën në luftën e madhe që kërkonte burra të fortë ,atdhetarë të flaktë,njerëz e patriot .E pra nga Arni i lartë u shkëputën nga zemrat tona dhe u futën në luftën legjendare të Kosovës për t'i dhuruar asaj lirinë shumë të dashur dhe të rrëmbyer nga njerëz dhe shtete të pa shpirtë!....

Arni është vendi ku fluturuan visarët e lirisë dhe shkrehën pushkën e dytë në Kosovë pas asaj pushke që dha sinjalin e parë për lirinë e saj!...

-Adem Jasharit!!!???

-Arni mbetet vendi, ku pati folenë trimëria!

-Arni është vendi, ku pati burimin patriotizmi!

-Arni vendi ku, në shekuj do të mbetet vend me histori me nder e plot lavdi!....

Prandaj lavdi Halit coka!

Lavdi Imer coka!

Lavdi Sami Coka!

Për ju jemi krenar,dhe krenaria jonë do të shëndrisë në zemrat e brezave të Arnit,të Kukësit dhe të tanë Shqipërisë!..

Pavarësia e Kosovës

Mendoja gjatë!? ... mendja më shkonte te ai dëshmori i Kosovës!.....

-Përse nuk më hapet goja ,gjuha më ka ngrirë!.....

Nga fjalët dëgjoj vetëm trimëri ,por dhe dhimbje!...

E përcolla dhimbjen ,putha trimërinë dhe i thash mendjes:

-"Trimëria e ka folenë këtu!..

-Lavdia e ka burimin këtu!...

-Këtu shëndrit liria!...

U mrekullova,mora forcë!...dhe....

Hodha nga nga pas gjithëçka të dhimbëshme!

Mora një tufë lule,i putha fortë dhe i vendosa mbi varre!...U ktheva rëndë! .... Rëndë!....Sikur mbi supe rëndonte një botë e tërë!?

Trupi im shkonte përpara,koka mbeti nga pas,sytë shikonin prapa!....deri sa lapidari u zhduk në horizont!....Së bashku me ëndërrat e mia plot optimiste dhe plot Shpresë!

-"Largohëm i qetë,të rroni ju për të na ruajtur pavdekësinë tonë"!..

Ë prap me kokën pas ,thot përsëri:Jam roja juaj i dashur atdhe dhe në rast së kush ju ngacmon ,do ngrihem nga varri e përsëri në luftë e në krah më ke!.....Qëndroni të qetë se ne jemi roja juaj, jemi fitorja juaj e nga pavdekësia jonë ,do merrni frymë lirisht ju dhe gjithë Kosova e gjithë Shqipëria"!..

--Dhe i qetë.....u largua në pavekësi!!....

LAPIDARI

Duke kaluar në Gllogjan atje ku u bë luftë e madhe....Aty ra për të mos vdekur kurrë heroi Halit Coka,pashë një lapidar sa të lartë e të bukur që shëndriste në lartësi...

Mendja më shkoj menjëherë në horizont dhe pyeta vehten:

-Ç'është ky lapidar?!...

Dëshmorët më një herë më thanë:

"-Është krenaria jonë që e ndërtuam me kurmin e trupit tonë!....

Lart zemrat o heronjë!

-E ngritëm me gjakun tonë!.. .. -Lart zemrat tuaja!!

-Nga lartësia e lapidarit ndjen frymëmarrjen e gjithë Kosova!...-Nga bukuria e lapidarit është ofshama e popullit!....

-Nga emrat e shkruar në të janë zemrat e nënave,baballarëve ,vllëzërve dhe motrave të tyre që ndjejnë dhimbjen që nuk i kanë pranë zemrave tyre,po janë krenar dhe kjo krenari shkëlqen deri në qiell të lartë e në thellësinë e shekujve.Për ata që fituan luftën dhe shkruan historinë me gjakun e tyre!...

Ata thonë :__"Do te endemi maleve e fushave,në tërë Kosovën,atje ku dhame jetën!...Perherë do endemi dhe do të jemi me ju,...rojet tuaja,mburojë e barrikadë e pakapërcyeshme e gjithë Kosovës!.....

E në mesin e tyre shëndrit dhe është më tepër se krenar njeriu ynë më i nderuar Halit Coka!....

Mes trimave Kosovarë

Qëndroi i heshtur ,e me dhimbje të thellë pran varrit të Halitit!... Kisha dëshirë të dëgjoja krismat e pushkës së tij që këndonte këtyre anëve!...Ajo iku !?.... U shua ka hërë!..

-Dua të dëgjoj për trimëritë e heroizmin e tij,në këto fusha e këto vende!...Këto i shoh në lapidarin madhështorë.

-Dua të flas ,por nuk mundem!...

E ky burrë i habitur nga përgjigja burrërore e këtij djali sa i ri dhe sa trim ishte ky djal.

Ai u habit për vendosmërinë,mençurinë e patriotizmin e pafund të tij.Merr rrugën ngadalë,i zhytur në mendime të thëlla,sa krenar për përgjigjen ashtu dhe pse i bëri një pyetje të tillë një djali vullnetar,trim e i vendosur për padrejtësinë që i bëhet popullit martir të Kosovës.

MENÇURI PASTRIOTIKE

Sa po përfundonte lufta ,Haliti mendonte më thellë për tu përgatitur për ditën tjetër ku luftimet çdo ditë e më tepër bëheshin më të vështira e më të përgjakshme.Doli nga pozicioni dhe u nis drejtë fushës së gjerë e mbuluar me gëzhoja ,me mina të plasur dhe të paplasur,për të

Prandaj nga zemra e shpirti të thëm:

-"I lehtë qoftë dheu që të mban në gjirin e tij"!..

SOT E NESËR

Sot erdha në Kosovë që, të shikoj fëmijë të gëzuar me lule në duar.-Shoh fusha të gjëra plot grurë të shëndetshme që dikur ishin të mbuluar me granata e mina vdekjeprurëse!...

_Shoh njerëz të gëzuar,shtëpi të bukura dhe male të shëndërruar në bukuri!..

Gëzohem e zemra me bëhet mal që nuk dëgjoj lajme jo të tmerrshme e plot dhimbje.

Kënaqem kur nuk shoh shtëpi të djegura e varre masive që dikur rrënonin zemra e mendje .

Shoh flladin e lirisë që bëhet i plotfuqishëm kudo në Kosovë. E pra në themelet e tyre qëndron gjaku i kuq i trimave me permasa legjëndare.

E sot gjithëkush është i gëzuar dhe i lumtur që në Kosovë lindi dielli, që ngroh zemrat e tërë popullit e rinisë Kosovare.

Në këtë diell bën dritë dhe pushka jote Halit Coka!...

Dhe gjaku juaj o patriot.

Dhe ideali juaj o atdhetar shembullor!

Në llogore barrikadë

Aty në Maznik ku luftimet bëheshin përditë e më të forta e më të tmershme,Haliti kishte bërë një pozicion të fortë e teknikishtë një llogore e përshtatur sipas luftës që bëhëj çdo ditë e më e rrezikshme.

Çdo ditë skuadra e Tij ndodhej më afër vdekjes por,çdo ditë më optimistë së kurrë për fitore në këtë luftë të përgjakshme.

Një ditë prej ditësh ishte afruar një burrë i moshuar dhe duke iu afruar Halitit e duke bisëduar më të për probleme nga më të ndryshme.

Në mes të tjerave ai e pyeti Halitin:_-"Pse, o Halit e ke bërë këtë pozicion kaq të fortë e të përshtatshëm për luftë"?--Haliti më gjakftohtësi, i buzëqeshur i përgjigjet:

-"Mua më quajnë Halit Coka,jam vullnetar në këtë luftë,për lirinë e Kosovës.Nuk do të kthehem i gjallë në vendin tim pa fituar lirinë kjo Kosovë e përgjakur.

Pandaj ky pozicion do të jetë vendi ku do burojë liria e Kosovës dhe unë do të jem krenar kur do marshoj bulevardit të Prishtinës me flamurin e fitores në dorë"!?....

punoj dhe jetoi i ati i tij ,Riza Coka,mjeshtër i punës dhe i zanatit,novator i shkëlqyer,punëtorë i palodhur.

Ishte fat i madh për Halitin pasi moshën më të mirë dhe kritike për jetën e kaloi në qytetin e Shkodrës,vend dhe djepi i kulturës shqiptare. Ai jo vetëm mori arsimin bazë në këtë qytet,por dhe u edukua me një kulturë të gjërë qytetare. Ai u formua si djal i mrekullueshëm,i urtë i sjellshëm me këdo,i dashur me të gjithë.

Një nga vetitë e tij më të spikatura ishte se ai punoi dhë luftoj për tu bërë njeri i ditur, njohuri të cilat i merrte nëpërmjet leximit në vijushmëri dhe sistematikishtë.Ai kishte dëshirë të lexonte ato libra që flisnin për trimëri,siç ishin këngët për kreshnikët,apo vepra të tjera plot trimëri.

parë terrenin për luftrat që do zhvilloheshin të nesërmen.

Ai me pushkë në krah e shumë vigjilent për ndonjë sulm befasues,ecte në fushën e gjërë.

Pa pritur,Ai dëgjon një zë tepër te lartë e befasues!..

O ushtar,thirri ai.

-"Pse u fute në arën dhe po më prish barin që më duhet për lopën"?!...

Haliti i habitur merr drejtqëndrim, shikon sa lartë anash dhe duket ai burrë diku aty afër.

Merr frymë thellë,qëndron drejtë në këmbë dhe i përgjigjet:

-"O axh !...

Mos u mërzit shumë për barin që shkelin këmbët e mia,pasi në thembrën e kësaj këpuce flen liria jote.E këtë tokë të mbuluar me barë ,do ta vadis

me gjakun tim rinor,dhe ka për të prodhuar kaq shumë barë që do të hajë edhe lopa edhe ju i nderuar burrë e trim kosovar"..

Ai mbeti pa zë dhe i ofenduar nga përgjigja e mençur dhe më një sarkazëm klasike.

Më falni,thot Kosovari,mirë ma bëre se më foli gjuha para mendjes. E Haliti vazhdon rrugën në drejtimin e tij dhe ai mbetet duke menduar thellë.

Eh!... paska dhe djem të tillë Shqipëria!...

MESAZHE NGA FRONTI I LUFTËS

Është tepër mallëngjyese dhe shumë krenare,që të udhëtosh për të shkuar në vendlindjen e deshmorit të Kosovës,Halit Coka.Rrugë e gjatë që gjarpëron në ato lugina të thella e plot pyje me lisa të gjatë e të hollë,ma male të lartë e plot pyje të mrekullushme.Ai lindi në këtë fshat më 25

korrik 1974.Fshat i cili shtrihet në rrëzë malit të Zepës dhe duket tamam si një fole dallëndyshje.

Në këtë fshat kanë jetuar e punuar në kushte të vështira,mes dëborës e stuhive ,me tokë të paktë e pak prodhuese.

Në këtë vend kan lulëzuar në shekuj vetitë më burrërore të një malësori tipik.Është shquar gjithëmonë për trimëri ndaj çdo pushtuesi, besnikërinë e madhe e të pa tundër,mikpritjen e bujarinë shembullore.Në mungesë të shkollavë dhomat Arnore, kan qënë vendi ku u muarën kulturë e dituri e u kultivua zgjuarësia.Në këto dhoma u muar dhe u edukua atdhetaria e patriotizmi shëmbullor.

Në një ambjent të tillë lindi Halit Coka,ku pati fillimin e jetës së tij.Ai largohet nga ky fshat për të jetuar në disa qytete të vendit tonë, pasi atje

Një formim të gjërë e mori nëpërmjet traditave të mrekullueshme të Shkodrës, u pais me një humor të mrekullueshëm shkodran, që trasmetoheshin brez pas brezi prej tyre dhe kishin vlera të mëdha educative.

Shpeshherë ai shkruante dhe fliste me pasion të madh:-"Populli ynë i mrekullueshëm,pasi dhe në kohën kur nuk kishte shtet, pushtohej e shkatërrohej, ruajti në zemër e në mendje traditat më të mira që iu deshën popullit për të mbijetuar si, trimëria,atdhetaria e patriotizmi.

Çdo gjë u ruajt në mendje e në zemër të popullit tonë ,të cilën e trasmetoi brez pas brezi pasi nuk mund ta shkruante dot sepse vrastarët e armiqtë i djegnin pa lindur akoma".

E pra ky popull dhe paraardhësit tanë kanë qënë të mrekullueshëm e ta pamposhtur sepse na

Pra qëndron mbi dashurinë për nënën,mbi dashurinë për babën, mbi dashurinë vllazërore e miqësore". Këto fjalë filozofike që buronin nga goja e tij,që përmbanin trimëri e vetëmohim,ndiznin zemrat e i hidhnin në sulm trimat dhe bashkëluftëtarët në betejat më të përgjakshm.

O vllezërit e mi,thoshte Haliti,perandorët hoqën nga fronti një duzinë mbretër , të fortë e të fuqishëm, por do të zhgënjehen kur nuk mposhtin dot një grusht shqiptarësh si puna jonë,

që luftojmë për atdhe,për të mbrojtur jetë të pa fajshme,të sulmuar nga armiqtë më të egër e të pa shpirtë.

Serbët nuk lanë gjë pa bërë kundrejtë fatzijve Kosovarë.Forca mposht gjitheçka.Kosovarët

dhuruan ne trashgushmërinë gojore, nëpërmjet të cilave mësuam atdheun,guximin, trimërinë dhe ndershmërinë kombëtare, të cilat të paktë kombe e kanë.

Shpirtin e flijimit për të ruajtur Atdhenë,lirinë e traditat tona sa të bukura dhe madhështore.

Do kisha dëshirë të kisha lindur në ato kohëra,kur burrat prodhuan burrërinë,kur trimat dhanë trimëri në mbrojtjen e vendit tonë sa të dashur dhe të mrekullueshëm,thoshte Haliti, në bisedat e ngrohta që ai bënte me shokët dhe bashkmoshatarët e tij.

Jo larg në kohë,iu krijuan kushtet për të cilat ai ëndërronte.Të provoj burrërinë pa u burrëruar. Të trimëroj pa u afirmue në moshën që duhej të reflektonte këtë.Mori rrugën plot sakrifica,në shi e dëborë ,në stuhi e furtuna dhe më në fund u

gjend në rrjeshtat e ushtrisë së uçk,dhe u bë luftëtari më aktiv,më i pamposhtur,më trimi,për t'i dal zot popullit vëlla të Kosovës,që masakrohej,përdhunohej digjej e shkrumohej dhe aq më këq largimi nga trojet e veta etnike.

Shpsh në frontet e luftës ,Ai thoshte fuqishëm më zë të lartë:

"Në qoftë së kan uri ,le të vijnë e të han gjoksin tim,të nxjerrin zemrën time që nuk shuhet kurrë. Askujt të mos i shkoi në mendje se unë do të hap rrugë.

Kurrë nuk do të zbrapsem që të pranoj robërinë,për të shpëtuar jetën time.

Jetën e dua shumë ,si gjithëkush tjetër,por dashuria për të vërtetën triumfon mbi të gjitha dashuritë.

plot bukuri,që ruanin vështrim të thellë,të gjallë e depërtues,plot rini e gjallëri,të frymëzonte të jepte respekt,me kë qëndronte e kuvendonte sado pak.

Ai,të impononte nderim e konsideratë pa dallim moshe,ideje feje e rrace.

Shquhej për fisnikëri e sjellje shembullore. Gjatë kohës që ai jetoi e punij si mërgimtarë në Greqinë largët, shquhej për punë të ndershme e voluminoze,për të siguruar të ardhura për familjen e për vehte.Natyra i kishtë dhënë një zgjuarësi të rrallë,një mendje të shëndosh e të hollë,kishtë një gjykim dhe një arsyetim të thellë duke dhënë mendime të vlefshme për këdo dhë kurdoherë.Ai kishte zemër të madhe e të ndjeshme ndaj çdo vlere positive apo negative qoftë ajo.

edhe pse u larguan,flamurin e morën me vehte,e sa herë kërciste pushka ai valvitej dhe rrezatonte shpresë dhe vetëm shpresë,vazhdonte Ai. Mendja e ndritur e Halit Cokës, shfaqte përveç,trimërisë,urtësisë,kishte nevojë për ushqim,të cilin e merrte,nëpërmjet përvojës në luftë,nëpërmjet lëximit që ai lexonte dhe në frontin ë luftës.

Fantazia e tij poetike kalontë kufijtë e diturisë,duke e parë botën shumë larg në kohë e hapësirë si dhe zhvillimet filozofike.

I pëlqente të lexonte libra që bënin fjalë për trimëritë,për heroizmat të cilët i nxisnin dhe i ushqenin entuziazmin e tij në luftë plot arritje.

Ai,dhe në kushtet më të vështira shprëhej:-"Si nuk pata fatin që të lindja në ato kohëra të trimave e trimërive,ku ata me shpatën e

tyre,shkatërruan çdo padrëjtesi e urrejtje ndaj njerëzve të mirë e të pafajshëm".

Nuk më harrohet dhe i kam të freskëta në mendjen time fjalët e dëshmorit ,pa u bë dëshmor,më thoshte me buzën plot gaz ëeharmoni:

- "Njëriu duhet të jetë i vyrtytshëm për të qënë i dashur nga të tjerë.

Shpirtmadh e zemërgjërë për tu respektuar nga të tjerët.Guximtar e trim,për të qënë i admiruar".AI,shquhej për shpirtëgjërësi dhe syhapur për të parë botën e duke bërë dallimin qartë e saktë,midis shpirtit të hipokritit e të tradhëtarit, atij që don lirinë,dhe atij që kërkon ta rrëmbejë atë.Falë zemërimit që i ndezi në shpirtë e në zemër sulmi misterioz i paramilitarëve serb mbi popullin trim e të urtë të

Kosovës.Nuk arriti të mposhtë durimin dhe emocionet therëse në zemrën e tij,kur gjaku shkonte lumë,loti shkonte rrëke në faqet e njerëzve të pafajshëm të cilët kërkonin ndihmë ndihmë. Dëshira,padurimi,druajtja prindërore e vllazërore e një mori luftë ndjenjash në botën shpirtërore ,ndezën një flakë dhe shëndrii një vendim të barabartë me shumë jetë:--Do të luftoj për lirinë e Kosovës.

Për vllezërit motrat e mia, që torturohen e masakrohen në mënyrën më makabër.

Vendimi u muar,zbatimi i padiskutushëm.

Është kënaqësi të jap në imagjinatën tuaj dhe disa cilësi fizike të spikatura në karaktërin e tij.

I gjatë e trupmadh,me pamje të bukur e madhështore,i hijshëm e plot shkëlqim.Me fëtyrë të qeshur e plot hieshi,me ato sy të zinjë

Kudo që shkonte e luftonte rregullonte pozicionin për të qënë i garantuar në çdo luftë si në mbrojtje dhe në sulm.

Çdo ditë qohej herët për të parë situatën e për të përcaktuar luftimet e mëpastajshme ,me pjekuri e vetëmohim.

Ishte data tre prill 1999.Ai pa forca të shumta,ku kishin mbushur transhetë.

Tanke të shumtë në gadishmëri të plotë gati për sulm ndaj forcave të uçk.Haliti menjëherë shpejtoi për të dhënë sinjalin e luftës që minutat i ndajnë.Duke shpejtuar ai pa befas,grykat e pushkëve të kryqëzuar,grykat e topave që gojën e kishin të hapur gati për sulm.,

Menjëherë krismat e breshëria hap zjarrë... tanket si të tërbuar vërsulen ndaj forcave të uçk.

mbyllën kurrë!...dora i kishte ngrirë mbi pushkë e syri shikonte mbi flamur!....

Një jetë e shuar,mijëra zemra të helmuara...Një armë e një trim më pak në uçk!?...

E nga zemra ime e helmuar por dhe krenare,burojnë fjalët më të lavdishme: -"Lavdi veprës suaj legjendare Halit Coka!

-Lavdi trimërisë,patriotizmit.atdhetarisë!

-Lavdi familjes që te lindi ,te rriti dhe te edukoi një trim të tillë,një atdhtar të flaktë dhe një dëshmor lirije te tille!

" E shumë rëndë është flamuri
Po peshon më rëndë së guri.
Në front të luftës ,në prag të lirisë
Ka ra trimi i Shqipërisë"!

Nga ky moment mua më vijnë në mendje kujtimet e gjata dhe mesazhet që ,Ai, më

Lufta filloi. Zjarr e flakë ndezin tokën.Një mjergullnajë mbulon vendin. Breshëri e furtunë e paparë në të katër anët.Një çetë e vogël por me zemër të madhe, luftëtarët qëndron të pa tundër në këtë tranëshe.Trimëri e rrallë ,guxim i madh,vetëmohim i paparë .Luftë e madhe e një grupi të vogël të uçk ,më forca të shumta në numër dhe në armatim.

Lufta sa vinte e shtohej,vendi ushtonte nga zjarri i armëve.Tymi dhe flaka mbuloj vendin.

Koha kalon dhe njerëzit po luftojnë me vetëmohin dhe kurajo duke patur besim në fitore dhe të vendosur për të çarë rrethimin më një fitore madhështore. Lufta arriti kulmin .Moment tepër kritikë.

Zjarri frontal me armë e me tanke filloi ofensivën për të shkelur me këmbë dhe me tanke drejt

tranëshesë ku luftonin Halit coka bashkë me trimat e tjerë.

Erdhi momenti kur do të vendosej vdekje me nder , përball këtij sulmi që marshonte si një ortek që nuk e ndalonte asgjë.

Haliti,çohet në këmbë dhe me antitank qëllon mbi tanke që vërsuleshin si një bishë e çmendur.

Predha godet zingjrin e majtë e shkatërron atë,tym e flakë ngrihet në qiell.

Tanku fillon të rrotullohet mbi zingjirin tjetër merr flakë.Tymi i zi ngrihet lartë,ekipi e ushtarët sërb u mbytën në flakë.Pa pritmas një snajpër godet Halitin,i cili nuk pushonte goditjen ndaj brëzit në luftim.Ai ra për të mos vdekur kurrë!!...Tymi filloj të hapet,pushkët ndaluan zjarrin,çdo gjë një betejë e përgjkshme. Aty në transhe qëndronte Haliti me ato sy që nuk iu

Gjaku ynë do të vadis këtë tokë të lashtë,nuk do të shuhet kurrë dhe nga kjo vaditje, ky vend do të prodhojë gjithmonë trima e heronjë të mëdhenjë për kombin.

Kurëdoherë dhe sa të këm shpirtë prej luftëtari në minutat e fundit do të buroj fuqishëm urimi para vehtes e zotit të madh:

-"O zot i madh ju lutem me dashurinë e zemrës sime,për Kosovë të kesh shumë mëshirë,ta ndihmosh të fitoj lirinë e humbur e të rrëmbyer nga gjakpirës të pangopur.Ti falë asaj drejtësi,dhe t'i heq nga qafa zgjedhën e rëndë prej një shëkulli të mallkuar për Kosovën."

.-"Le ta marrë vesh kushdo dhe zoti do ta thotë me mallkim, se njerëz të tillë maskarenjë, përdhunojnë të vrasin e të djegin!?

dërgonte nga fronti i luftës e midis të tjerave ai më shkruante:

